



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|   |            |           |                       |
|---|------------|-----------|-----------------------|
| Numri i Protokollit /<br>Protokol Number /<br>Doc. No. / No. of the<br>Protocol | 09.12.2021 | 1         | with<br>1000<br>pages |
| Organizimi /<br>Organization /<br>Org. / Org.                                   | SPM/SJK    | 5939/2021 | 115                   |
| Titulli i Protokollit /<br>Title of the Protocol /<br>Title of the Protocol     |            |           |                       |
| Shënimet /<br>Remarks /<br>Remarks  |            |           |                       |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS**

A.Nr.930/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2005/2021 të datës 09.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka shqyrtuar ankesën A.nr.480/2021 të datës 02.06.2021 të parashtruar nga ankuesit

të cilët me autorizim i përfaqëson avokatja nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit Agjencia Kadastrale e Kosovës, në çeshtjen juridike-administrative “kompensim material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.480/2021 e datës 02.06.2021 e ankuesve**

**II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve dhe të cilët me autorizim i përfaqëson avokatja**

### **A r s y e t i m**

Grup ankuesish që të gjithë të punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me datë 02.06.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës për periudhën nga janari 2015 deri dhjetor 2018 sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( me tej KPSHCK), me datë 05.08.2021 përmes shkresës me numër protokolli 4098/2021, ka njoftuar ankuesit se Këshilli për shkak të mungesës së anëtareve nuk mund të shqyrtoj ankesën A.nr. 480/2021 të datës 02.06.2021, duke e udhëzuar të njëjtit për te drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin me numër A.nr.2005/2021 të datës 09.11.2021, ka aprovuar kërkesën padinë e paditëseve dhe ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK të datës 05.08.2021, duke e obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.480/2021, të datës 02.06.2021.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën A. nr.480/2021 të datës 02.06.2021 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin e datës 31.05.2021; Akt Emërimin e datës 19.03.2013 për Akt Emërimin e datës 11.02.2021 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Akt Emërimin e datës 11.02.2012 për Akt Emërimin e datës 11.02.2012 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Akt Emërimin e datës 11.02.2012 për Akt Emërimin e datës 11.02.2012, për Akt Emërimin e datës 01.06.205 për Akt Emërimin e datës 01.02.2012 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Akt Emërimin e datës 18.02.2013 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Sara Xhafa; Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Akt Emërimin e datës 08.02.2012 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Akt Emërimin e datës 31.01.2012 për Akt Emërimin e datës 31.01.2012 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për Akt Emërimin e datës 11.01.2012, për Akt Emërimin e datës 01.10.2014 për Akt Emërimin e datës**



|   |                                      |                      |
|---|--------------------------------------|----------------------|
| 11.01.2012 për  | Akt Emërimin e datës 01.11.2011 për  | Akt                  |
| Emërimin e datës 13.03.2014,për                           | Akt Emërimin e datës 16.12.2013 për  |                      |
| Akt Emërimin e datës 01.12.2012 për                       | Akt Akt Emërimin e datës             |                      |
| 11.01.2012 për  | Akt Emërimin e datës 11.01.2012, për | Akt                  |
| Emërimin e datës 11.01.2012 për                           | Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për  |                      |
| Akt Emërimin e datës 11.10.2014 për                       | Akt Emërimin e datës 11.01.2012      |                      |
| për   | Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për  | Akt Emërimin e datës |
| 11.01.2012 për  | Akt Emërimin e datës 01.01.2012 për  | Akt Emërimin         |
| e datës 11.01.2012 për                                    | Akt Emërimin e datës 01.11.2012 për  |                      |
| Akt Emërimin e datës 01.11.2012 për                       | Akt Emërimin e datës 01.11.2012 për  |                      |
| Akt Emërimin e datës 02.06.2014 për                       |                                      | Përgjigje në         |
| ankesë e datës 18.06.2021, me numër protokolli 3178/2021. |                                      |                      |

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesve si në pikën e I të dispozitivit të këtij vendimi, është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesit fillimisht me datë 01.06.2021 i janë drejtuar më kërkesë më shkrim organit të punësimit përmes së cilës kanë kërkuar realizimin e së drejtës tyre lidhur me kompensimin e shujtës ditor në vlerë prej dy (2) euro për çdo ditë pune për periudhën nga 1 janar 2015 deri dhjetor 2018 ashtu siç përcaktohet me nenin 54 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre më autorizim, me datë 02.06.2021 parashtrojnë ankesë me pretendime të njëjta në KPMSHCK, duke propozuar që Këshilli të obligoj Qeverinë e Kosovës respektivisht Ministrinë e Financave që ankuesve t'ju kompensoj shpenzimet e ushqimit në vlerë prej 2 Euro, për çdo ditë pune, që nga 1 janari 2018 deri në dhjetor 2018 me kërcenim të përmarimit me dhunë.

Kolegji bazuar në vlerësimin e Akt Emërimeve të ankuesve ka konstatuara se ankuesit sipas pikës I të dispozitivit janë të punësuar në Agjencinë Kadastrale e Kosovës me statusin e nëpunësit civilë gjegjësisht ankuesi ka pozitën e punës " Zyrtar për përkthim shqip serbisht dhe anasjelltas " ankuesja ka pozitën e punës " Menaxhere e Prokurimit", ankuesja ka pozitën e punës " Administratore-Programer i databazës ", ankuesja ka pozitën e punës " Zyrtarë Certifikues", ankuesi ka pozitën e punës " Drejtor në Departamentin e Matjes", ankuesja ka pozitën e punës " Administrator i Sistemit", ankuesi ka pozitën e punës " Ekspert i matjes", ka pozitën e punës "Ekspert i GIS", ankuesi Nishori ka pozitën e punës " Udhëheqës i Sektorit-RDPP-SIKTK", ankuesi ka pozitën e punës " Ekspert për Kadastër", ankuesi ka pozitën e punës " Shef i Sektorit të Produkteve", ankuesja ka pozitën e punës " Ekspert i GIS-it", ankuesja ka pozitën e punës "Ekspert Kadstral", ankuesi ka pozitën e punës "Shef i Divizionit të Administratës", ankuesja ka pozitën e punës " Ekspert i TI/ Administrator i bazës së të dhënave", ankuesi ka pozitën e punës " Ekspert i Matjes", ankuesja ka pozitën e punës "Zyrtar



për Barazi Gjimore", ankuesi ka pozitën e punës "Drejtor i Departamentit Ligjor", ankuesi ka pozitën e punës "Shef i Sektorit për Matje", ankuesi ka pozitën e punës "Zyrtar i Produkteve", ankuesja ka pozitën e punës "Zyrtare e barazimit të hyrave dhe pasurive", ankuesja ka pozitën e punës "Zyrtare e Lartë Ligjore", ankuesja ka pozitën e punës "Zyrtar i Lartë Ligjore", ankuesi ka pozitën e punës "Zyrtar i pranimit dhe mbajtjes së parasë së imtë/ Logjistikë", ankuesja ka pozitën e punës "Zyrtar i Lartë Ligjor", ankuesi ka pozitën e punës "Specialistë i IT", ankuesi ka pozitën e punës "Ekspert i TI, Administrator i Aplikacioneve", ankuesi ka pozitën e punës "Ekspert i TI/ Administrator i Rrjetit", ankuesja ka pozitën e punës "Zyrtare e Arkivit", ankuesi ka pozitën e punës "Zyrtar i shpenzimeve dhe zotimeve", ankuesi ka pozitën e punës "Ekspert për Kadastër", ankuesja ka pozitën e punës "Drejtoreshë në Drejtoratin e Administratës dhe Financave", ankuesja ka pozitën e punës "Ekspert i GIS-it", ankuesi ka pozitën e punës "Eksperte e GIS-it", ankuesi ka pozitën e punës "Ekspert i GIS-it", ankuesja ka pozitën e punës "Menaxhere e Personelit", ankuesja ka pozitën e punës "Shef i Divizionit të Financave", ankuesi ka pozitën e punës "Ekspert për GIS/Hartografi", ankuesi ka pozitën e punës "Ekspert për Kadastër dhe GIS", ankuesja

Draga ka pozitën e punës "Veterinar ne LUV", ankuesja ka pozitën e punës "Zyrtare e Lartë ligjore",

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilin janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 38/2014 më datë 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vite, respektivisht deri më datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Bazuar në konstatimin e lartcekur dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesve si në pikën 1 të dispozitivit të këtij vendimi për realizimin e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punës është parashkruar, kështu që pretendimi i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin të Kosovës, është jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, *sepse:*

Ankuesit dhe ipas Akt Emërimeve mbajnë pozitën e punës "Vozitës" ndërsa ankuesja mbanë pozitën "Receptioniste" dhe mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se këto pozita duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht nenin 2 paragrafi 2.4 hyjnë



në kategorinë e nëpunësve administrative teknik dhe mbështetës ku përcaktohet se *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.* Andaj, ankuesit si në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nuk e kanë statusin e Nëpunësit Civil, kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesit kanë statusin e Nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve

dhe

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rikujton ankuesit se nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda A. nr.930/2021

**Rushit KAJTAZI**

*Procesmbajtës*

**Ardita HAXHNIKAJ - DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesve avokates
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së